

AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE "ULUSAL" SH.P.K.

Sipas Ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëria Tregtare" dhe Ligjit nr 9723, date 03.05.007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" themelohet sot në datën 25.10.2023, shoqëria "ULUSAL" shpk. Adresa e shoqërisë është Lagja 28 Nentori, ndërtesa 109/1 z.k. 8523, numur pasurie 8/371-N8 me sipërfaqe totale 49.3 m2, Elbasan, me ortak të vetëm znj. Mehtap Demircin.

VENDOSI:

Krijimin e një shoqërie tregtare me emrin "ULUSAL" shpk. me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Themeluesi, krijon shoqërinë tregtare "ULUSAL shpk", me një statusin ligjor të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në bazë të ligjit nr 9901 të 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me burimet e veta financiare dhe kontributet e paguara në cash.

Neni 2

Kompania gëzon statusin e personit juridik dhe aktivitetet e saj rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi, sipas këtij akt themelimi dhe Statutit të aneksuar.

Neni 3

Kompania do të ushtrojë biznesin e tij nën emrin "ULUSAL" shpk, shpk, dhe ky emërtim do të shënohet në të gjitha dokumentet, letrat, faturat, etj.
Kompania ka vulën e vet në të cilën është shkruar "ULUSAL" shpk, Elbasan, Shqipëri.

Neni 4

Selia e kompanisë është e vendosur në Elbasan, Lagja 28 Nentori, ndërtesa 109/1 z.k. 8523, numur pasurie 8/371-N8 me sipërfaqe totale 49.3 m2,
Kompania ka kompetenca të hapë dhe të mbyllë agjencitë e tjera në qytete të tjera të Shqipërisë apo jashtë vendit, nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 5

Periudha e aktivitetit të kompanisë do të jetë i pakufizuar, përveç në rastet kur ortakët vendosin

shpërbërjen me të hershme e aktivitetit.

Neni 6

Kompania ushtron veprimtarinë e saj me objekt:
Import, eksport, tregeti me shumice dhe pakice të artikujve të argjendarisë, kozmetikës si dhe artikujve të ndryshen industriale.

Neni 7

Me vendim të themeluesve, kompania mund të ndryshojë emrin, vendin, statusin ligjor dhe qëllimin e punës, mbasi të deklarojë ndryshimet në këtë akt dhe në statutin e saj.

Neni 8

Kapitali i kompanisë i paguar plotësisht në mjete monetare është caktuar fillimisht nga ortakët në masën 100.000 (njëqindmijë) leke.

Kapitali shoqërisë përbehet nga një kuotë e cila zotërohet nga ortakët i vetëm znj. Mehtap Demircin.

Neni 9

Kompania zhvillon biznesin e saj për të bërë fitime. Ajo është përgjegjëse për detyrimet që ka ndaj shtetit dhe ndaj personave të tjerë, që nga themelimi i saj.

Neni 10

Kompania kryen aktivitetin e saj administrativ, ekonomik e financiar, në përputhje me legjislacionin aktual dhe me statutin e bashkangjitur.

Drejtimi i shoqërisë do të bëhet nga organet e saj drejtuese, të cilat përbëhen prej administratorit të saj.

Ortakët marrin vendim për emërimin e ekspertit kontabel.

Kompania do të mbajë llogaritë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe do të krijojë një fond rezervë.

Fitimi neto që do të rezultojë në fund të çdo viti financiar, pas zbritjes së fondit rezervë dhe humbjeve të rezultuara nga vitet e mëparshme, do të shpërndahet ortakeve.

Neni 11

Përcaktimi i strukturës organizative të kompanisë, funksionet, dhe dorëheqja e organeve të tij merren nga organet drejtuese.

Administrator i shoqërisë "ULUSAL" shpk shpk, emerohet znj. Mehtap Demircin me nje afat prej pesë vjetësh.
Marrëdhëniet e Punës, do te bazohen ne kontratat e punës, dhe ne ligjin përkatës.

Neni 12

Rregullat për menaxhimin, organizimin dhe prishjen e shoqërisë, janë përcaktuar në statut që është bashkëngjitur në këtë akt themelimi.

Ortaku i vetem i shoqërisë "ULUSAL" shpk

Mehtap Demircin

Mehtap Demircin

